

VENDIM
Nr.580, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË POLIÇAN TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Poliçan të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Poliçan të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.620, datë 14.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Poliçan të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Poliçan

Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-2	Varrezat publike	Në pronësi
3-11	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
13-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
23-24	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
25-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
68	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e Mbrojtjes civile	Në pronësi
69-72	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
73,84-88	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
74-75	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
77,12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

78-83	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
-------	--------------------------------	------------